

**MEDFAU SH.P.K
SHENIMET SHPJEGUESE**

Pasqyrat Financiare te mbyllura ne daten

31 Dhjetor 2020

MEDFAU SH.P.K.

Shenime per pasqyrat financiare per vitin mbyllur me 31 Dhjetor 2020

1 Hyrje

Shoqëria MEDFAU Sh.p.k., themeluar si Shoqëri me përgjegjesi të kufizuar më datë 01/11/2000, me NUIS J93610823R.

Aktiviteti i shoqerise rregullohet me Ligjin nr. 9901 date 14.04.2016 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe nga statuti, si dhe nga legjislacioni shqiptar. Objekti i aktivititetit te shoqerise eshte: "Import export tregti te artikujve elektronike e industriale, asistence teknike ne fushen e elektronikes, pajisjeve mjekesore e elektrike.Tregeti te konsumablate medicinale. Import dhe tregtim medikamentesh me shumice. Shitje me pakice te artikujve elektronike, industriale, pajisjeve mjekesore etj..

Me 31 Dhjetor 2020, Shoqeria operon nga selia qendrore ne Kavaje, me adresë "Lagja 5".

Kapitali i nenshkruar eshte regjistruar ne Leke shqiptare.

Me 31 Dhjetor 2020, perqindja e aksioneve te mbajtura nga aksioneri, me nje vlore per aksion prej 208,000 leke eshte si me poshte:

- Shkëlqim Verdha 208,000,000 ALL or 100%

Me 31 Dhjetor 2020, numri i punonjesve eshte 46 (2019: 38 punonjes).

II. Baza e Pregatitjes

(a) Parimi i perputhshmerise

Paqyrat financiare jane pregatitur ne perputhje me Standartet Financiare Nderkombetare te Raportimit (IFRS) sipas kerkesave te Ligjit Nr. 9228 date 29.04.2018 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", pasi shoqeria eshte ne listen e shoqerive qe ne baze te te vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 783 date 22.11.2006 duhet te zbatoje SNRF-te, pasqyrat financiare me te fundit jane adoptuar ne pajtim me SNRF-te.

(b) Parimi i Matshmerise

Keto pasqyra financiare jane pregatitur mbi bazen e kostos historike.

(c) Monedha funksionale

Keto pasqyra financiare jane paraqitur ne Leke.

MEDFAU SH.P.K.

Shenime per pasqyrat financiare per vitin mbyllur me 31 Dhjetor 2020

II. Baza e Pregatitjes (vazhdim)

Menyrat e vleresimit dhe gjykimit

Pregatitja e pasqyrave financiare kerkojne qe menaxhimi te beje gjykime, vleresime dhe supozime qe ndikojne ne zbatimin e politikave dhe ne shumat e raportuara te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Vleresimet dhe supozimet qe i shoqerojne bazohen ne eksperienca historike dhe faktore te tjere te cilet besohet se jane te arsyeshem ne rrethana te caktuara, rezultat i te cilave krijon bazen per gjykimet mbi vlerat e mbeturat te te drejtave dhe detyrimeve. Rezultatet aktuale mund te ndryshojne nga keto vleresime. Vleresimet dhe supozimet e nenkuptuara jane rishikuar ne vazhdimesi. Rishikimet e vleresimeve kontabel njihen ne periudhen ne te cilen behet rishikimi dhe ne periudhat e ardhshme qe preken. Ne vecanti, informacioni mbi fusha te rendesishme te pasigurise se vleresimit dhe gjykimit kritik ne perputhje me politikat kontabel qe kane efektet me domethenese ne shumat e njoitura ne pasqyrat financiare jane përshtuar ne Shenimin 5.

Politikat kontabile te dhena me poshte jane aplikuar ne vijimesi ne te gjitha periudhat e paraqitura ne keto pasqyra financiare

III. Permblehdhe e politikave kontabel

(a) Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj jane kembyer me kursin e kembimit te dates se transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj jane kthyer me kursin e kembimit ne mbyllje te vitit. Diferencat nga kursi i kembimit jane te njoitura ne pasqyren e fitimit ne Rezultate neto te kembimit. Aktivet dhe detyrimet jo monetare ne monedhe te huaj qe jane paraqitur me kosto hisorike jane kthyer me kursin e kembimit te dates se transaksionit. Aktivet dhe detyrimet jo monetare ne monedhe te huaj qe jane paraqitur me vlere tregu Jane kthyer me kursin e dates kur eshte percaktuar vlera e tregut.

Normat e kembimit (Lek per monedhe te huaj) per monedhat kryesore me 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 jane si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
1 EUR	123.70	121.77
1 USD	100.84	108.64

(b) Instrumentat financiare

Instrumentat financiare jo – derivative perfshijne investimet ne letra me vlere te kapitalit, ne llogari te arketueshme dhe te tjera te arketueshme, mjete monetare ne arke dhe ne banke, kredi dhe hua, llogari te pagueshme dhe te tjera te pagueshme. Me 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 nuk ka instrumenta financiare derivative. Asetet financiare jane matur fillimisht me vleren e duhur duke shtuar kostot e transaksionit qe jane te lidhur direkt me pervesimin e tyre. Njohja ne vazhdim e aseteve financiare jo derivative përshtruhet si me poshte.

Mjetet monetare ne arke dhe ne banke perfshijne tepericat ne para. Overdraftet e ripagueshme me kerkese dhe qe formojne pjese integrale ne administrimin e mjetete monetare te shoqerise, per qellime te pasqyres se fluksit te arkes. Regjistrimi kontabel per te ardhurat financiare dhe shpenzimet eshte sqaaruar ne shenimin III.k.

MEDFAU SH.P.K.

Shenime per pasqyrat financiare per vitin mbyllur me 31 Dhjetor 2020

III. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

Instrumentat financiare per shoqeri te lidhura.

Shoqeri te lidhura jane ato entitete ne te cilat ne kemi influence sinjifikative, por nuk kemi kontroll, mbi politikat financiare dhe operative.

Kapitali aksioner

Kapitali i aksionerve te Shoqerise njihet me vlere nominale.

Dividentet

Dividentet njihen si detyrim per periudhen ne te cilen ata deklarohen.

Te tjera

Aktive te tjera financiare maten me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv dhe duke zbritur humbjet nga zhvleresimi.

(c) Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Zerat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me koston e tyre historike shoqeria nuk ka bere rivleresuar akivet afatgjata materiale

Kostot perfshire shpenzimet qe jane bere direkt te atribueshme per blerjen e aktivit. Kostot e aktivit te ndertuara nga vete shoqeria , perfshin koston materiale dhe te fuqise pughtore, si dhe ndonje kosto tjeter qe lidhet direkt me venien e aktivit ne kushte pune, si dhe kostot e cmontimit dhe te zhvendosjes dhe te magazinimit te tyre ne vendedodhjen perkatese. Kosto e financimit ne lidhje me blerjen apo ndertimin e aktiveve specifike njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve me te ndodhur.

Kur pjesa te nje zeri te aktiveve afatgjata materiale kane jete te dobishme te ndryshme,ato kontabilizohen si zera te ndryshem (komponente kryesor) te aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitja e nje zeri te aktiveve afatgjata materiale vendosen duke krasuar te hyrat monetare nga shitja me vleren e mbartur te aktiveve materiale te trupezuara , dhe njihen neto brenda zerit “ te ardhura te tjera ” ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve . Kur aktivet e rivleresuara shiten, sasite e perfshira ne rezerven se rivleresimit transferohen ne fitimin e mbajtur, ndersa deficiti i rivleresimit njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimit te periudhes.

(ci)Kostot e mepasshme

Kostoja e zevendesimit te nje pjesa te aktiveve afatgjata materiale njihen ne vleren mbartur te nje zeri nese eshte e mundur qe perfitime ekonomike te ardhshme te trupezuara ne pjesa do te qarkullojne ne Shoqeri dhe kostoja e saj mund te vleresohet besueshem. Vlera e mbartur e pjeseve te zevendesuara nuk njihen .

MEDFAU SH.P.K.

Shenime per pasqyrat financiare per vitin mbyllur me 31 Dhjetor 2020

III. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

Kostoja e sherbimeve ditore te aktiveve afatgjata materiale njihet ne pasqyren e te ardhurave e shpenzimeve ku ndodhin

(cii) Amortizimi

Amortizimi njihet ne pasqyren e te ardhurave e shpenzimeve me baze lineare per te gjitha asetet per Vitin 2019 sipas IFRS, per ndertesat dhe instalime te per gjithshme me baze lineare mbi jeten e dobishme te vleresuar te cdo pjese te nje zeri te aktiveve materiale te trupezuara dhe me metoden zbritse per makinerite dhe paisjet, mjetet e transportit, paisjet e zyres dhe kompjuterike dhe aktivet e tjera me nje norme amortizimi sic shpjeguar me poshte. Toka dhe punimet ne proces nuk amortizohen. Me poshte jane perafersime te jetes se dobishme:

<u>Baze vlera e mbetur</u>	31.12.2020 (ne%)	31.12.2019 (ne%)
• Ndertesa	5	5
• Instalime te per gjithshme	5	5
• Instalime teknike, makineri dhe pajisje	20	20
• Mjete transporti	20	20
• Pajisje zyre-furniture	20	20
• Kompjutera dhe pajisje zyre-kompjutera	25	25
• Aktive te tjera	20	20

(d) Aktive afatgjata jomateriale

Tarifat e konsulences dhe te vleresuesve te pavarur klasifikohen te cilat kapitalizohen si aktive afatgjata jomateriale. Nuk eshte bere nje vleresim nese shpenzimet e kerkimit klasifikohen ne perputhje me IAS 38 ose nuk ka nje analize nese ne lidhje me fizibiliteten e tij tegetar ose teknologjik, dhe ne se kostot mund te maten ne menyre te besueshme.

Amortizimi njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve me baze lineare mbi jeten e dobishme e aktiveve afatgjata jomateriale nga data qe ato jane gati per perdonim. Jeta e dobishme per aktivet afatgjata jomateriale ne 31.12.2020 eshte per 10 vjet (2019 ; 10 vjet)

(e) Inventari

Inventari vleresohej me vleren me te ulet midis kostos dhe vleres se realizueshme . Kostoja e inventarit bazohet ne Koston mezatare te ponderuar, dhe perfshin shpenzime te ndodhura gjate blerjes se inventarit, kosto prodhimi ose kosto transformimi dhe kosto te tjera te lidhura me sjelljen e tyre ne kushtet dhe pozicionin ekzistues. (Ne rastin e inventarit te prodhuar dhe prodhimit ne process, kosto perfshin nje pjese te caktuar shpenzimeve te per gjithshme te prodhimit bazuar ne kapacitetin normal te aktivitetit nuk ka .)

Vlera e realizueshme neto eshte cmimi i shitjes i vleresuar ne rrjedhen normale te biznesit, minus kostot e finalizimit dhe shpenzimet e shitjes.

(f) Perkeqesimi

MEDFAU SH.P.K.

Shenime per pasqyrat financiare per vitin mbyllur me 31 Dhjetor 2020

III. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

(i) Aktivet financiare

Nje aktiv finanziar vleresohet ne cdo date bilanci per te percaktuar nese egziston ndonje tregues per perkeqesimin e aktivit. Nje aktiv finanziar konsiderohet per tu perkeqesuar nese ka evidence objektive qe tregon se nje ose me shume ngjarje kane patur nje efekt negative ne flukset e ardheshme te vleresuara te aktivit.

Nje humbje nga perkeqsimi e lidhur me nje aktiv finanziar te vleresuar me kosto te amortizuar, llogaritet si diferenca midis vleres se mbetur dhe vleres se tashme te flukseve te ardhshme te parashikuar te skontuar me normen efektive te interesit . Nje humbje nga perkeqsimi i nje aktivi finanziar te mbajtur per shitje llogaritet duke iu referuar vleres se tij te drejte . Aktivet financiare qe jane individualisht te medhenj testohen per perkeqesim ne menyre individuale. Aktivet e mbetura financiare vleresohen se bashku ne grupe qe kane karakteristika te ngjashme te rrezikut te kredise. Te gjitha humbjet nga perkeqesimi njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Cdo humbje e akumuluar e lidhur me ndonje aktiv finanziar te mbajtur per shitje e njojur me pare ne kapital, transferohet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Nje humbje nga perkeqesimi stornohet nese stornimi mund te lidhet ne menyre objective me nje ngjarje te ndodhur pas njojhes se humbjes nga perkeqesimi. Per aktivet financiare te matura me kosto te amortizuar dhe aktivet financiare te mbajtura per shitje qe jane letra me vlere te borxhit, stornimi njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Per aktivet financiare te mbajtura per shitje qe jane letra me vlere te kapitalit, stornimi njihet drejtperdrejte ne kapital.

(ii) Aktivet jofinanciare

Vlerat kontabel te aktiveve jofinanciare te Shoqerise , pervec inventarit dhe aktiveve te tatimit te shtyre, rishikohen ne cdo date raportimi per te percaktuar nese egziston ndonje tregues per perkeqesim. Nese egziston ndonje tregues i tillë, atehere duhet vleresuar shuma e rikuperueshme e aktivit. Per emrin e mire dhe aktivet e paprekshme qe kane jete te papercaktuar ose qe nuk jane ende te gateshem per perdonim, shuma e rikuperueshme vleresohet ne cdo date raportimi.

Shuma e rikuperueshme e nje aktivi ose e nje njesie qe gjeneron para eshte me e madhja midis vleres se saj ne perdonim dhe vleres se saj te drejte minus kostot e shitjes. Gjate vleresimit te vleres ne perdonim, flukset e ardhshme te pritshme te parase skontohen ne vleren e tyre aktuale duke perdonur nje norme skontimi para tatimit qe pasqyron vleresimet aktuale te tregut te vleres ne kohe te parase dhe rreziqet specifike per aktivin. Per qellime te testimt te perkeqesimit aktivet grupohen se bashku ne grupin me te vogel te aktiveve qe gjeneron flukset hyrese te parase te aktiveve te tjera ose grupeve te tjera te aktiveve ("njesite qe gjenerojne para ").

Nje humbje nga perkeqesimi njihet nese vlera kontabel e nje aktivi ose njesia e tij qe gjeneron para tejkalon shumen e tij te rikuperueshme te parashikuar. Humbjet nga perkeqesimi njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Humbjet nga perkeqesimi te njoitura ne lidhje me njesite e gjenerimit te parase perdoren me pare per te paksuar vleren kontabel te emrit te mire qe mund t'i jete ngarkuar njesive dhe me pas per te paksuar vleren kontabel te aktiveve te tjera te njesise (grupi i njesive) ne menyre perpjestimore. Humbjet nga perkeqesimi te njoitura ne periudhat e meparshme vleresohen ne cdo date raportimi per ndonje tregues qe humbja eshte pakesuar ose nuk egziston me. Nje humbje nga perkeqesimi stornohet nese ka pasur ndryshim ne parashikumet e bera per te percaktuar shumen e rikuperueshme. Nje humbje nga perkeqesimi stornohet deri ne masen qe vlera kontabel e aktivit te mos tejkaloje vleren kontabel qe do te ishte percaktuar, minus zhvleresimin ose amortizimin, nese nuk do te ishte njojur humbje nga perkeqesimi .

MEDFAU SH.P.K.

Shenime per pasqyrat financiare per vitin mbyllur me 31 Dhjetor 2020

III. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

(g) Perfitimet e punonjesve

(i) Kontributet e detyrueshme te sigurimeve shoqerore

Shoqeria paguan vetem kontribute te detyrueshme te sigurimeve shoqerore qe u sigurojne perfitime pensione punonjesve pas daljes ne pension. Qeveria shqiptare eshte perjegjese per sigurimin e kufirit minimal te caktuar me ligj per pensionet ne Shqiperi sipas nje plani te percaktuar kontributesh pensioni. Kontributet e Shoqerise ne planin e perfitimit te pensioneve ngarkohen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve atehere kur ndodhin.

(ii) Leje vjetore e paguar

Shoqeria njeh si detyrim shumen e paskontuar te kostove te parashikuara lidhur me lejen vjetore qe pritet te paguhet ne kembim te sherbimit te punonjesve per periudhen e perfunduar.

(h) Provizonet per rreziqe

Nje provision njihet ne qofte se, si rezultat i nje ngjarje te shkuar, Shoqeria ka nje detyrim aktual ligjor ose te terthorte qe mund te vleresohet ne menyre te besueshme, dhe eshte e mundur qe nje fluks dales perfitimesh ekonomike do te kerkohet per te shlyer detyrimin. Provizonet percaktohen duke skontuar fluksset e ardhshme te pritshme te parase me nje norme para tatimit qe pasqyron vleresimet aktuale te tregut te vleres ne kohe te parase dhe rreziqet specifike per detyrimin .

(i) Ristrukturimi

Nje provision per ristrukturim njihet kur Shoqeria ka miratuar nje plan te detajuar dhe formal ristrukturimi , dhe ristrukturimi ka filluar ose eshte shpallur publikisht . Per kostot e ardhshme operative nuk llogaritet provision .

(ii) Restaurim i truallit

Ne perputhje me politiken e publikuar mjedisore te Shoqerise dhe me kerkesat ligjore ne fuqi, nje provision per restaurim trualli ne lidhje me tokat e ndotura, dhe shpenzimi perkates njihet kur toka eshte ndotur.

(iii) Kontratat "onerous"

Nje provision per kontratat e onerous njihet kur perfitimet e pritura te Shoqerise nga nje kontrate jane me te vogla se kostot e pashmangeshme per te perm bushur detyrimet e saj sipas kontrates.

Provizoni matet si vlore aktuale e me te vogles midis kostos se pritur ne rast prishjeje te kontrates dhe kostos neto te pritur ne rast vazhdimi te kontrates. Perpara krijimit te provisionit, Shoqeria njeh cdo humbje nga perkeqesimi i aktiveve te lidhura me ate kontrate.

(i) Njohja e te ardhurave

(i) Mallrat e shitur

III. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

Te ardhurat nga shitja e mallrave jane matur me vleren e drejte te pagesave te arketuara ose te arketueshme , pakesuar me tatimet dhe taksat mbi shitjet dhe mbi fitimin (akcizat , taksat e rruges , dhe te tjera te ngjashme) . Te ardhurat njihen kur rreziqet dhe perfitimet nga pronesia Jane transferuar te blerese, arketimi i pagesave eshte i mundshem, kostot e lidhura dhe kthimi i mundshem i mallrave mund te parashikohen ne menyre te besueshme, nuk ka pjesmarrje te metejshme ne menaxhimin e mallrave dhe shuma e te ardhurave mund te matet ne menyre te besueshme. Transferimet e rreziqeve dhe te perfitimeve ndryshojne ne varesi te kushteve specifike te kontrates se shitjes.

(ii) Sherbimet

Te ardhurat nga sherbimet e kryer jane njojur si fitim ose humbje ne perpjestim me fazen e perfundimit te transaksionit ne daten e raportimit . Faza e perfundimit vleresohet duke iu referuar inspektiveve te punes se kryer.

(iii) Te ardhurat nga qeraja

Te ardhurat nga qeraja mbi pronat per investime njihen si fitime ose humbje ne menyre lineare per gjate afatit te qerase. Incentivat e dhena gjate afatit te qerase jane njojur si një pjese integrale e te ardhurave totale nga qeraja, per gjate afatit te qerase.

(j) Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen atehere kur ndodhin.

(k) Pagesat e qerase

Pagesat minimale te qerase bere per qerate financiare jane ndare ndermjet shpenzimit financiaridhe paksimit te detyrimit ekzistues. Shpenzimi financiar eshte shperndare ne cdo periudhe per gjate afatit te qerase ne menyre qe te paraqese një norme te pandryshueshme interesit

mbi tepricen e mbetur te detyrimit . Pagesat e mundshme te qerase kontabilizohen duke shqyrtuar pagesat minimale te qerase per gjate afatit te mbetur te qerase, pasi te konfirmohet korrigimi i qerase .

(l) Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat financiare perfshijne te ardhurat nga interesi i balancave me bankat dhe te ardhurat nga kembimi valuator qe njihen si fitime ose humbje. Te ardhurat nga interesi njihen mbi baze rrjedhese , duke perdorur metoden e interesit efektiv .

Shpenzimet financiare perfshijne humbjet nga kembimi valutor.

(m) Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin mbi fitimin ose humbjen per vitin perfshin tatimin aktual dhe ate te shtyre . Tatimi mbi fitimin eshte njojur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve per vec pjeses qe lidhet me zera te njojur drejtperdrejt ne kapital, rast ne te cilin ai njihet ne kapital .

Tatimi aktual eshte tatimi i pagueshem i pritshem mbi te ardhurat e tatushme te vitit, duke perdorur normat tatile ne fuqi ne daten e hartimit te bilancit, dhe cdo rregullim te tatimit te pagueshem ne lidhje me vitet e kaluara.

III. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

Tatimi i shtyre llogaritet duke perdorur metoden e detyrimeve te bilancit , duke siguruar diferenca e perkohshme midis vleres se mbartur te aktiveve dhe detyrimeve per qelime te raportimit finansiar dhe shumave te perdonura per qellime tatimi .Shuma e llogaritur e tatimit te shtyre bazohet ne menyren e pritur te realizimit ose shlyerjes se vleres se mbetur te aktiveve dhe detyrimeve , duke perdorur normat tatumore ne fuqi ne daten e pergatitjes se bilancit .

Nje aktiv i shtyre tatumor njihet vetem ne qofte se ekziston mundesa e realizimit te fitimeve te tatushem perkundrejt te cileve aktivi mund te perdoret. Aktivet tatumore te shtyre reduktohen ne momentin qe nuk eshte me e mundur qe perfitimet tatumore te lidhura me to te realizohen.

(n) Standarte te reja dhe interpretime qe kane filluar te zbatohen

Ne daten e autorizimit te ketyre pasqyrave financiare, kishin dale interpretimet dhe amendimet e reja te meposhteme te standarteve me rendesi per veprimtarite e Shoqerise, qe kane hyre ne fuqi dhe jane zbatuar plotesisht gjate pergatitjes se ketyre pasqyrave financiare :

IFRS 7 Instrumentet financiare ; Shenime Sqaruese.

Standarti do te kerkoje me shume sqarime ne lidhje me instrumentet financiare te Shoqerise. Ai zevendeson SNK 30, Shenimet sqaruese ne Pasqyrat Financiare te Bankave dhe te Institucioneve Financiare te Ngashme dhe eshte i zbatueshem nga te gjitha njesite qe pergatisin pasqyra financiare ne perputhje me SNRF. Shoqeria gjykon se sqarimet e rendesishme shtese qe kerkohen do te lidhen me objektivat, politikat dhe proceset e drejtimit te rrezikut te saj financiar.

IFRS 8 Segmentet Operative

Standarti kerkon shenime sqaruese mbi segmentin bazuar mbi perbersit e njesise qe menaxhimi monitoron gjate marrjes se vendimeve mbi ceshtjet operative. Segmentet operative jane perberes te nje njesie per te cilet eshte i disponueshem informacion financiar i vecante qe vleresohet rregullisht nga marresi kryesor i vendimeve operative kur vendos se si t'i shperndaje burimet dhe kur vlereson performancen. Shoqeria gjykon se kerkosat e standartit do te kene ndikim pjeserisht te rendesishem mbi pasqyrat financiare .

IFRIC 7 Zbatimi i Perqasje se Korrigimit sipas IAS 29 Raportimi Financiar ne Ekonomite Hiperinflacionare, kerkon zbatimin e IAS 29 kur nje ekonomi fillimisht shnderrohet ne hiperinflacionare dhe ne vecanti ne kontabilizimin e tatimit te shtyre . IFRIC 7, i cili eshte bere i detyrueshem per pasqyrat financiare te Shoqerise per vitin 2018, nuk ka ndonje ndikim mbi pasqyrat financiare.

IFRIC 8 Qellimi i IFRS 2 Pagesat me ane te aksioneve adreson kontabilizimin e transaksioneve te pagesat me ane te aksioneve ku disa ose te gjitha mallrat apo sherbimet e marra nuk mund te identifikohen ne menyre specifike. IFRIC 8 i cili eshte bere i detyrueshem per paqyrat financiare te Shoqerise per vitin 2019, nuk ka ndonje ndikim mbi paqyrat financiare .

IFRIC 9 Rivleresimi i Derivativeve te Fshehur kerkon qe nje rivleresim nese derivativet e nenkuptuar duhet te ndahen nga kontratat baze mikepriteze te behet vetem kur ka ndryshime ne kontrate .IFRIC 9, i eshte bere i detyrueshem per pasqyrat financiare te Shoqerise per vitin 2019, nuk ka ndonje ndikim mbi pasqyrat financiare.

MEDFAU SH.P.K.

Shenime per pasqyrat financiare per vitin mbyllur me 31 Dhjetor 2020

III. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

IFRIC 10 Raportimi Financiar dhe Perkeqesimi i Ndermjetem ndalon kthimin mbrapsht te nje humbjeje nga perkeqesimi te njojur ne nje periudhe te meparshme te ndermjetme ne lidhje me emrin e mire, investimin ne nje instrument kapitali ose aktivin financier te mbajtur me kosto. IFRIC 10, i cili eshte bere i detyrueshem per pasqyrat financiare te Shoqerise per vitin 2019, nuk ka ndonje ndikim mbi pasqyrat financiare .

IFRIC 11 IFRS 2 Group dhe Transaksionet me Aksione Thesari kerkon qe nje marrveshje me pagesa me ane taksioneve ne te cilin nje entitet merr te mira dhe sherbime ne shkembim te instrumenave te kapitalit e cila duhet te njihet si nje transaksion me pagesa me ane te aksioneve , pavarsisht nese instrumentat e kapitalit jane marre. Po ashtu jep udhezime ne marrveshjet e transaksioneve me aksione , net e cilat furnizuesit e te mirave dhe sherbimeve te nje entiteti jane dhene me instrumenta kapitali te shoqerise meme te entitetit , dhe duhet te njihet si nje transaksion me pagesa me ane te aksioneve, pavaresisht ne se instrumentat e kapitalit jane marre ne considerate ne pasqyrat financiare te entitetit. IFRIC 11, i cili eshte bere i detyrueshem per pasqyrat financiare te Shoqerise per vitin 2019, nuk ka ndonje ndikim mbi pasqyrat financiare.

IFRIC 12 Rregullimi i Sherbimeve te Koncesionit udhezon njesite e sektorit privat mbi ceshtje te caktuara te njojhes dhe matjes qe lindin ne kontabilitet per rregullimet e sherbimeve te koncesionit nga sektori public tek ai privat. IFRIC 12 i cili eshte bere i detyrueshem per pasqyrat financiare te Shoqerise per vitin 2019, nuk do te kete ndonje ndikim mbi pasqyrat financiare.

Amendim i IAS 1 Paraqitura e Pasqyrave Financiare; Si nje amendim plotesues i lindur nga IFRS 7 (shiko me siper) , standarti do te kerkoje me shume shenime sqaruese ne lidhje me kapitalin e Shoqerise. Shoqeria nuk pret qe ky amendim te kerkoje sqarime te rendesishme shtese persa i perkthet struktura se kapitalit te shoqerise.

IFRIC 13 Programet e Klienteve Loyal adreson trajtimin kontabel nga entitetet qe operojne, ose qe marrin pjese, ne programet e klienteve loyal per klientet e tyre . Kjo lidhet me program nen te cilat klienti mund te perfitoj produkte ose sherbime shtese me skonto ose falas. IFRIC 13, i cili eshte bere i detyrueshem per pasqyrat financiare te Shoqerise per vitin 2019, nuk ka ndonje ndikim mbi pasqyrat financiare.

IFRIC 14 IAS 19-Limitet e nje Aktivi Benefiti te percaktuar, Kerkesat dhe nderveprimi e Financimeve Minimale sqaron kur rimbursimet dhe reduktimet ne kontributet e ardhshme ne lidhje me aktivet e benefiteve te percaktuara duhet te trajtohen si te vlefshme dhe jep udhezime ne ndikimin e kerkesave te financimit minimal (MFR) te ketij aktivi. Po ashtu adreson kur nje MFR mund te krijoj nje detyrim. IFRIC 14, i cili eshte bere i detyrueshem per pasqyrat financiare te Shoqerise per vitin 2019, nuk ka ndonje ndikim mbi pasqyrat financiare.

IV. Administrimi i riskut financiar**Veshtirim i pergjithshem**

Shoqeria eshte e ekspozuar ndaj rrisqeve te meposhteme per shkak te perdorimit te instrumentave financiare

- Risku i kredise
- Risku i likujditit
- Risku i tregut

IV. Administrimi i riskut financiar (vazhdimi)

Ky shenim paraqet informacion mbi ekspozimin e shoqerise ndaj secilit risk te permendur me siper , objektivat e Shoqerise, politikat dhe proceset per matjen dhe administrimin e riskut, dhe per administrmit te kapitalit te shoqerise . Shenime te tjera cilesore dhe sasiore jane te perfshira ne pasqyrat financiare.

Drejtoria ka perjegjesine per krijimin dhe kontrollin e sistemit te administrimit te riskut per Shoqerine. Drejtoria raporton rregullisht tek Keshilli mbikqyres mbi aktivitetin e tij.

Politikat per administrimin e riskut te Shoqerise jane vodosur per te identifikuar dhe analizuar risqet e hasura nga Shoqeria, per te percaktuar limitet dhe kontrollet e pershtateshme per cdo risk dhe per te monitoruar risqet dhe zbatimin e limiteve.

(i) Risku i kredise dhe perqendrimi

Pozicioni financiar i klienteve te Shoqerise dhe marredheniet me ta ne te ardhmen mund te kete nje efekt sinjifikative ne pozicionin financiar te Shoqerise.

Risku i kredise eshte risku i humbjes financiare per Shoqerine ne qofte se nje klient ose pala tjeter ne nje instrument financiar nuk i permbush detyrimet kontraktuale, dhe rrjedh kryesisht prej arketimeve te Shoqerise nga klientet dhe letrat me vlere te investimit.

Kliente dhe te arketueshem te tjera

Ekspozimi i Shoqerise ndaj riskut te kredise ndikohet kryesisht nga karakteristikat individuale te cdo klienti. Baza individuale e klientit ne shoqeri duke perfshire riskun e industris aktive afatgjata jomateriale dhe te vendit ku operon klienti, ka influence me te vogel ne riskun e kredise.

Megjithate, nuk ka nje perqendrim gjeografik te riskut te kredise.

Shoqeria nuk ka percaktuar nje politike kreditimi tek ndonje klient.

Shoqeria ka percaktuar nje tolerance per demet, qe perfaqesojne vleresimin e saj per humbjet qe kane ndodhur ne lidhje me arketimet nga tegetia dhe te tjera , te cilat jane miratuar me pare nga asambleja e aksionerve. Perbersit kryesor te kesaj jane humbjet specifike qe lidhen me ekspozime individuale te rendesishme

MEDFAU SH.P.K.

Shenime per pasqyrat financiare per vitin mbyllur me 31 Dhjetor 2020

IV. Administrimi i riskut financiar (vazhdimi)

(ii) Risku i likujditetit

Risku i likujditetit eshte rreziku qe Shoqeria nuk do te arrije te plotesoje detyrimet e saj financiare ne maturimin e tyre. Rruga qe ndjek Shoqeria per menaxhimin e likujditetit eshte te siguroje, per aq sa ka mundesi, qe do te kete gjithmon likujditet te mjaftushem per te permbugur detyrimet e saj ne maturim, ne kushte normale dhe te forcuar, pa krijuar humbje te papranueshme ose demtime riskore per reputacionin e Shoqerise.

(iii) Risku i tregut

Risku i tregut eshte rreziku qe ndryshimet ne cmimet e tregut, si kursi i kembimit dhe normat e interesit do te ndikojne ne te ardhurat e Shoqerise ose ne vleren e instrumentave te saj financiar. Objektivi i administrimit te riskut te tregut eshte te administroje dhe te kontrolloje ekspozimin ndaj riskut te tregut brenda parametrave te pranueshem, nderkohe qe pritet nje kthim optimist.

Risku i kursit te kembimit

Shoqeria nuk eshte e ekspozuar ne menyre domethenese ndaj riskut te kursit te kembimit per sa i perket shitjeve ndersa per blerjet po sepse ato jane te vleresuara valute.

Transaksione te tjera te rendesishme kryhen ne monedha te tjera si Euro ose USD .

Kredite dhe huate regjistrohen ne monedhen me te cilin do te kete hyrje ne para nga operacioni ne fjale i Shoqerise, kryesisht Euro.

MEDFAU SH.P.K.

Shenime per pasqyrat financiare per vitin mbyllur me 31 Dhjetor 2020

2. Aktivet Afatgjata Materiale

Me 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 Aktivet Afatgjata Materiale paraqiten si me poshte:

	Toka	Ndertesa	Instalime teknike, makineri, pajisje,instrumente dhe vegla pune	Mjete transporti	Mobilje e pajisje zyre	TOTAL
AAM Vlera Bruto						
Gjendje 01.01.2020	76,598,780	57,539,045	74,082,292	29,581,023	18,397,665	256,198,805
Shtesa		106,654,478	20,078,612	610,850	475,928	127,819,868
Pakesime	56,298,773	23,506,974		1,408,000		81,213,747
Riklasifikime nga CIP						-
Tjeter						-
Gjendje 31.12.2020	20,300,007	140,686,549	94,160,904	28,783,873	18,873,593	302,804,926
ZHVLERESIM i AKUMULUAR						
Gjendje 01.01.2020	-	6,292,299	45,849,509	21,678,220	13,645,715	87,465,742
Shtesa		2,706,757	4,926,105	1,813,209	1,234,305	10,680,376
Pakesime		1,900	-	409,413	-	411,313
Riklasifikime nga CIP						-
Tjeter						-
Gjendje 31.12.2020	-	8,997,156	50,775,614	23,082,016	14,880,020	97,734,805
Vlera e mbetur neto						
Gjendje 01.01.2020	76,598,780	51,246,746	28,232,783	7,902,803	4,751,950	168,733,064
Gjendje 31.12.2020	20,300,007	131,689,393	43,385,290	5,701,857	3,993,573	205,070,122

Ka patur shtesa gjate vitit 2020 per ndertesa (rikonstruksion) ne vleren 106,654,478 leke, per instalime teknike makineri e pajisje ne vleren 20,078,612 leke, per mjete transporti ne vleren 610,850 leke, per mobilje dhe pajisje zyre ne vleren 475,928 leke. Amortizimi eshte llogaritur sipas normave te IFRS.

3. Aktivet Afatgjata Jo Materiale

Me 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 Aktivet Afatgjata Jo Materiale paraqiten si me poshte:

	Per vitin e mbyllur me 31/12/2020	Per vitin e mbyllur me 31/12/2019
AA jomateriale	529,278	529,278
TOTAL	529,278	529,278

MEDFAU SH.P.K.

Shenime per pasqyrat financiare per vitin mbyllur me 31 Dhjetor 2020

4. Inventaret

Gjendja e inventareve gjate periudhes 1 Janar deri me 31 Dhjetor 2020 paraqitet si me poshte:

	Gjendja inventareve ne fillim te periudhes	Blerjet e periudhes	Gjendja e inventareve ne fund te periudhes	Kosto e shitjeve
Mallra per rishitje.	182,988,246	950,955,054	257,730,220	419,201,856
Total	182,988,246	950,955,054	257,730,220	419,201,856

Inventaret maten fillimisht me kosto. Kostoja e inventareve perfshin: koston e te gjithe materialeve te lidhura drejtoperdrejt me mallrat e blera. Kostot e drejtoperdrejta perfshijne pavec cmimit te blerjeve dhe te gjitha kostot e tjera qe nevoiten per sjelljen e inventareve ne gjendjen dhe vendodhjen e tyre ne magazine.

Ne percaktimin e kostos se inventareve shoqeria jone ka perdorur mesataren e ponderuar.

5. Kerkesa te arketueshme

Me 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 Kerkesat e Arketueshme paraqiten si me poshte:

	31/12/2020	31/12/2019
Kliente	399,385,243	307,228,993
TOTALI	399,385,243	307,228,993
Zhvlersim i te drejtave (Klienteve)		
TOTALI NETO	399,385,243	307,228,993

6. Kerkesa te tjera te arketueshme

Me 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 Kerkesat e tjera te Arketueshme paraqiten is me poshte:

	31/12/2020	31/12/2019
Paradhenie per punonjesit	259,270	2,391,539
Parapagime te dhena	7,140,562	-
Tatimi ne burim (teprica debitore)	-	-
Tatim mbi fitimin	-	570,299
Shteti -TVSH per t'u marre	111,113	-
Debitore/Kreditore te tjere	379,322,948	363,933,867
Total	386,733,893	366,895,705

7. Aktive Monetare

Me 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 gjendja e aktiveve monetare paraqitet si me poshte:

	31/12/2020	31/12/2019
Gjendje ne arke (Cash ne dore)	975,487	65,219
Gjendje ne Banka (Cash ne Banka)	42,294,475	24,774,090
Total	43,269,962	24,839,309

MEDFAU SH.P.K.

Shenime per pasqyrat financiare per vitin mbyllur me 31 Dhjetor 2020

Kesh dhe ekuivalente te tij, perfshire ne shenimin e mesiperme, te analizuara ne monedhat qe vijojne:

	31/12/2020	31/12/2019
Monedha lokale [MEDFAU SH.P.K]	8,406,988	5,469,801
EURO	33,721,767	19,208,821
USD	154,123	95,469
GBP	11,597	-
Total	42,294,475	24,774,090

	31/12/2020	31/12/2019
Eur	272,609	157,747
ALL 2020 123.70; 2019 121.77	33,721,767	19,208,821
USD	1,528	879
ALL 2020 100.84; 2019 108.64	154,123	95,469
ALL	8,406,988	5,469,801
GBP	84	-
ALL 2020 137.93;	11,597	-
	42,294,475	24,774,090

Shoqeria ka llogari bankare ne dhjete Banka , gjithsej 26 llogari rrjedhese ne banka, si dhe nje llogari Depozite ne Raiffesien Bank ne vlore 140.000 €uro.

Monedhat e perdorura jane Lek euro, dollar dhe pound britanik. Gjendja e arkave dhe bankave ne dt 31.12.2020 eshte vleresuar me kursin e fund vitit 1 euro = 123.70 lek dhe dollar 100.84 leke.

8. Kapitali

Me 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 situata e kapitalit paraqitet si me poshte:

	31/12/2020	31/12/2019
Kapitali i autorizuar, i leshuar & Plotesisht i paguar.	208,000,000	208,000,000

8. Kapitali (vazhdim)

<i>Emri i Aksionerit (Ortakut)</i>	<i>Numri i aksioneve</i>	<i>Perqindja e aksionit</i>	<i>Vlera e aksioneve</i>
Shkelqim Verdha	100	100%	208,000,000
	100	100%	208,000,000

9. Rezervat

Me 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 Rezervat paraqiten si me poshte:

	31/12/2020	31/12/2019
Rezerva ligjore	7,015,866	7,015,866
Rezerva te tjera	474,679,168	386,864,443
Total	481,695,034	393,880,309

Rezerva ligjore ka patur rritje per vitin 2020 ne vleren 87,814,724 leke.

MEDFAU SH.P.K.**Shenime per pasqyrat financiare per vitin mbyllur me 31 Dhjetor 2020**

10. Hua Afatgjata

Me 31 Dhjetor 2020 gjendja e huave afatgjata paraqitet si me poshte :

Banka	Monedha	Pjese Afat shkurter	Pjese afatgjate	Totali	Norma e interesit	Kohe zgjatja deri me	Vendosje ripagimi
OTP Bank	EUR		106,759,140	106,759,140	3.50%	07.06.2021	
Raiffeisen Bank	EUR		75,342,388	75,342,388	4%	29.12.2020	
Total			182,101,528	182,101,528			

Shoqeria ne 07.06.2017 ka marre hua nga OTP Bank ne vleren 450,000 EUR me norme interesи 3.5% per tu shlyer deri me 07.06.2021.

Shoqeria ne 05.10.2018 ka marre hua nga OTP Bank ne vleren .470.000 EUR me norme interesи 3.5% per tu shlyer deri me 05.10.2025.

Shoqeria ne 15.07.2019 ka marre hua nga Raiffeisen Bank ne vleren 282.000 EUR me norme interesи 3.8% per tu shlyer deri me 19.02.2021.

Shoqeria ne 29.06.2018 ka marre hua nga Raiffeisen Bank ne vleren 300.000 EUR me norme interesи 4% per tu shlyer brenda deri me 29.12.2020.

11.Detyrime te tjera financiare

Me 31 Dhjetor 2020 gjendja e detyrimeve te tjera financiare paraqitet si me poshte :

	31/12/2020	31/12/2019
Detyrime te tjera financiare	26,551,720	0
Total	26,551,720	0

12. Llogari te pagueshme tregtare dhe llogari te tjera te pagueshme

Me 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 gjendja e llogarive te pagueshme paraqitet si me poshte :

	31/12/2020	31/12/2019
Llogari te pagueshme tregtare	137,699,621	83,712,595
LLogari te tjera te pagueshme	8,432,462	18,599,294
Total	146,132,083	102,311,889

Furnitoret e huaj ne valute jane vleresuar me kursin e fundit te vitit dhe diferencajan sistemuar ne pasqyrat e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Furnitoret Jane vlersuar me kursin zyrtar te fund vitit 1 euro=123.7 lek dhe 1usd=100.84 lek

Detyrimet ndaj furnitoreve Jane rritur ne krasim me vitin 2019.

MEDFAU SH.P.K.

Shenime per pasqyrat financiare per vitin mbyllur me 31 Dhjetor 2020

13. Hua Afatshkurtra

Me 31 Dhjetor 2020 gjendja e huave afatshkurtra paraqitet si me poshte :

Banka	Pjese Afat shkurter	Pjese afatgjate	Totali	Norma e interesit	Kohe zgjatja	Vendosje ripagimi
Overdraft Raiffeisen Bank ALL	13,316,789		13,316,789	3.80%	29.12.2020	
Overdraft Raiffeisen Bank Euro	74,592,004		74,592,004	3.50%	06.09.2020	
Overdraft OTP Bank	27,762,268		27,762,268			
Total	115,671,062	-	115,671,062	-		

Shoqeria ne 06.09.2019 ka marre (rinovuar) overdraft nga OTP Bank ne vleren 250.000 EUR me norme interesи 3.5% me afat 06.09.2020

Shoqeria ne 15.07.2019 ka marre overdraft nga Raiffeisen Bank ne vleren 600.000 EUR me norme interesи 3.8% per tu shlyer deri me 19.02.2020.

14. Detyrime te tjera financiare

Me 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 gjendja e detyrimeve te tjera financiare paraqitet si me poshte :

	31/12/2020	31/12/2019
Parapagim "Arketime ne avance per porosi"	35,669,768	15,869,324
Paga dhe shperblime	0	-
Detyrime per sigurimet shoqerore	1,309,392	994,726
Shteti per tatim taksa*	9,962,553	3,001,882
Total	46,941,713	19,865,932

Analiza e detajuar e detyrimeve ndaj shtetit paraqitet me poshte:

Analiza te shteti per tatim taksa	31/12/2020	31/12/2019
Tatim mbi te ardhurat personale	878,393	634,766
Tatim mbi fitimin	7,360,294	-
Shteti- TVSH për tu paguar	1,699,325	2,342,549
Tatimi në burim	24,541	24,566
Tatime te tjera	-	-
Total Shtesa	9,962,553	3,001,882

Detyrimet per Sigurimet Shoqerore + Shendetore dhe Tatim mbi pagën dhe Tatim ne burim janë paguar ne Janar te 2021.

MEDFAU SH.P.K.

Shenime per pasqyrat financiare per vitin mbyllur me 31 Dhjetor 2020

15. Tatim Fitimi

Me 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019, tatim fitimi paraqitet si me poshte:

	31/12/2020	31/12/2019
Tatim fitimi llogaritur	15,815,534	16,316,237
Tatim fitimi paguar gjate vitit		
Plus / Minus		
Tatimi mbi fitimin ne Bilanc	15,815,534	16,316,237
Fitimi ushtrimit	101,510,448	104,130,962
Plus : Shpenzime te panjohura	3,825,072	4,643,952
Shpenzime te tjera	101,374	
Taksa & gjoba		
Total	105,436,893	108,774,914
Fitimi para tatimit	105,436,893	108,774,914
Minus : Te ardhura jo te taksueshme		
Humbje taksash te viteve te meparshem		
Total	105,436,893	108,774,914
Perfitime te taksueshem		
Norma e tatimit mbi fitimin	15%	15%
Tatime te shtyra 17/b		
Tatim fitimi per vitin	15,815,534	16,316,237
FITIMI NETO NE BILANC	85,694,914	87,814,725

Ne llogaritjen te tatim fitimit jane mare parasysh shpenzimet qe nuk jane te njohura per efekte fiskale sipas legjislacionit tatimor.

16. Shoqeri te lidhura

Palët konsiderohen të jenë palë të lidhura nëse një palë ka mundësinë të kontrollojë ose të ushtrojë influencë të rëndësishme mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare ose operacionale, ose palët janë nën kontroll të përbashkët me Shoqërinë.

Me 31.12.2020 eshte bere rivleresimi me kursin 1 Euro = 123.70 leke per balancen e gjithe furnitoreve dhe klienteve ne euro.

MEDFAU SH.P.K.

Shenime per pasqyrat financiare per vitin mbyllur me 31 Dhjetor 2020

1. Te Ardhura dhe Shpenzime

Me 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 te ardhurat dhe shpenzimet e Kompanise paraqiten si me poshte:

a. Shitjet

	<u>01/01/2020-31/12/2020</u>	<u>01/01/2019 - 31/12/2019</u>
Shitje mallrash	647,744,747	660,014,247
Te ardhura nga shitje te tjera	40,449,801	7,154,927
Totali i: a) shitjeve	688,194,548	667,169,174

1. Te Ardhura dhe Shpenzime (vazhdim)

b. Te ardhura te tjera nga veprimtaria e shfrytezimit

<u>Shitje mallrash</u>	<u>31/12/2020</u>
Shitje e punimeve dhe e sherbimeve	125,851,382
Shitje mallrash	521,893,365
Qira	6,282,139
Te ardhura nga shitja e nderteses	33,406,422
Te ardhura nga shitja e mjeteve te transportit	761,240
Total te ardhura nga shitja e mallrave	688,194,548

c) Lende e pare dhe materiale te konsumuara

	<u>01/01/2020-31/12/2020</u>	<u>01/01/2019 -31/12/2019</u>
Materialet e konsumuara	419,201,856	435,316,358
Totali: c) Lende e pare dhe materiale te konsumuara	419,201,856	435,316,358

MEDFAU SH.P.K.

Shenime per pasqyrat financiare per vitin mbyllur me 31 Dhjetor 2020

d) Shpenzime te tjera

	<u>01/01/2020-31/12/2020</u>	<u>01/01/2019 - 31/12/2019</u>
Trajtimet e përgjithshme	5,,907,804	795,191
Qira	3,435,473	4,107,379
Mirëmbajtja dhe riparimet	2,503,271	3,966,634
Konsulencë	4,312,191	6,841,269
Shpenzime të tjera për aktivitetin	4,285,151	3,534,884
Shpenzimet e sigurimit	2,503,139	1,944,791
Shpenzimet për dieta	8,031,278	6,518,885
Shpenzimet e transportit	4,704,126	3,084,504
Shpenzimet e telefonit dhe internetit	1,887,088	2,067,934
Reklamim, Publicitet	2,869,619,	1,315,142
Shpenzime karburant	-	4,148,084
Komisionet bankare	4,237,049	3,790,313
Taksat dhe Doganat	1,378,672	1,214,240
Shpenzime jo të zbritshme	3,926,446	4,643,952
Vlera kontabël e aktiveve të shitura	25,503,660	-
Total i: d) Shpenzime te tjera	75,484,967	47,973,202

1. Te Ardhura dhe Shpenzime (vazhdim)

e) Kosto e Punes

	<u>01/01/2020-31/12/2020</u>	<u>01/01/2019 - 31/12/2019</u>
Paga bruto dhe rroge (wages)	60,969,739	54,865,171
Kontribut sigurime shoqerore per punetoret	7,425,134	6,606,782
Total	68,394,873	61,471,953
Kosto stafi te tjera		
(Pension charge) Pagese pensioni per vitin		
Total i: e) Kosto e Punes	68,394,873	61,471,953

f) Amortizimet dhe zhvleresimet

	<u>01/01/2020-31/12/2020</u>	<u>01/01/2019 - 31/12/2019</u>
Amortizimi i aktiveve afatgjata	10,680,377	11,459,118
Provizione per zhvleresimin e aktiveve financiare		
Shpenzime te tjera (humbjet nga rivleresimi aktiveve)		
Total i: f) Amortizimet dhe zhvleresimet	10,680,377	11,459,118

MEDFAU SH.P.K.

Shenime per pasqyrat financiare per vitin mbyllur me 31 Dhjetor 2020

a) Kembim monedhe (fitime)/humbje

	<u>01/01/2020-31/12/2020</u>	<u>01/01/2019-31/12/2019</u>
Kembim (fitime)/humbje qe rrjedhin gjate vitit	3,996,752	2,025,601
Kembim (fitime)/humbje qe rrjedhin nga vleresimi i fund-vitit te ardhurave/pagesave		
Total i: g) Kembim monedhe (fitime)/humbje	3,996,752	2,025,601

h) Kosto-te ardhura financiare neto

	<u>01/01/2020-31/12/2020</u>	<u>01/01/2019-31/12/2019</u>
Interes ne hua afatgjate		
Shpenzime te tjera financiare	8,950,068	9,650,422
Total i kostove financiare		9,650,422
Te ardhura nga investime		
Te ardhura te tjera nga interes i dhe te ngashme	-24,792	807,240
Total i te ardhurave financiare		807,240
Total i te ardhurave (kostove) financiare neto	8,925,276	8,843,182

Numri mesatar i punonjesve me 31.12.2020 dhe 31.12.2019 eshte si me poshte.

	<u>01/01/2020-31/12/2020</u>	<u>01/01/2019 - 31/12/2019</u>
Punetore qe paguhen me ore pune		
Punetore rrogetare	46	38
Total	46	38

Shpenzimet jane paraqitur ne menyre analitike sipas natyres se tyre.

Administrator

Shkëlqim Verdha



Nr. "Kojo Karrafi", Llogja 5, Kavaja
Re: "Naim Frasheri", Nr.731 Tirane
Tel/Fax: +355 42 270 367